

BREAKING NEWS

x

KUVENDI MERR VENDIMIN ME TE FUNDIT, MIRATON KOMISIONIN E POSAÇEM HETIMO...

AKTUALITET

Atentati në Vlorë/ Gjendet një makinë e djegur, policia: Ja si u arratisën autorët

SHKRUAR NGA SOT.COM.AL
14 JANAR 2019

Facebook

WhatsApp

Twitter

Email



Policia ka dhënë detaje të reja nga atentati që tronditi Vlorën mbrëmjen e sotme.

Mësohet se persona dy persona me motorr dhe të pajisur me skafandra kanë ndjekur makinën e tipit 'Audi A3', me targa AA 653 VC dhe kanë qëlluar me breshëri plumbash drejt saj.

Ngjarja ka ndodhur pranë një lokali në rrugën 'Gjergj Araniti', ndërsa raportohet se ka mbetur i plagosur 41 vjeçari Mikel Mehmeti, i cili dyshohet se ka qenë edhe shënjestër e atentatit.

Mehmeti është transportuar drejt spitalit të Vlorës dhe është në gjendje të rëndë shëndetësore, pasi ka marrë disa plumba në krahator.

Gjithashtu mësohet se Mikel Mehmeti është bashkëpunëtor i vëllezërve Llanaj në Vlorë.

Burime zyrtare bëjnë me dije se në afërsi të stacionit të trenit është gjetur duke u djegur një automjet, i cili dyshohet të jetë përdorur nga autorët për fshehjen dhe largimin e tyre.

Sakaq, policia ka hapur hetimet për identifikimin e autorëve dhe arrestimin e tyre.

Njoftimi i policisë Vlorë:

Sot rreth orës 17:40, në lagjen 'Pavarësia' dyshohet se është qëlluar me armë zjarri në drejtim të një automjeti e për pasojë ka mbetur i plagosur një 41-vjeçar. Ai po merr ndihmë mjekësore në spital.


Në afërsi të stacionit të trenit, Policia ka gjetur duke u djegur një automjet, i cili dyshohet të jetë përdorur nga autorët për fshehjen dhe largimin e tyre.

Shërbimet e policisë po krehin zonën për të bërë të mundur kapjen e autorëve.

Grupi hetimor ndodhet në vendngjarje ku vijon puna për zbardhjen e rrethanave të ngjarjes, si dhe identifikimin e autorëve.

YOU MAY LIKE

by **mgid**



**Pronađen glavni neprijatelj
dijabetesa! Šećer brzo pada do
4,1**

DIATEA